



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 665/ 2 prot.,

Datë 20.03.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME VLERËSIMIN ME PIKË TË PROPOZIMEVE TEKNIKE PËR VETE

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-92191-12-27-2023, me objekt “*Rehabilitimi i rrugëve në lagjen Metallaj, Karpen, Bodinok Nj. Ad Maminas*” me fond limit: 55.343.180 (pesëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK, me NIPT L78006801F dhe NIPT J61902509S, me adresa: Rruga “3 Dëshmorët”, godinë banimi dhe shërbimi 11 kate, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Shijak
Adresa: Lagja “Erzen” Shijak.

Në datën 19.03.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/3910 dhe me nr. 665/2024 prot, datë 19.03.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-92191-12-27-2023, me objekt “*Rehabilitimi i rrugëve në lagjen Metallaj, Karpen, Bodinok Nj. Ad Maminas*” me fond limit: 55.343.180 (pesëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK.

Bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriterin e vlerësimit dhe objektin e pretendimeve që bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK parashtron në ankesën me nr. 665/2024 prot., datë 19.03.2023.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

çmimi më i ulët pikët **0- 60**

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën

Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit pikët **0- 30**

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për ti transformuar kërkesat e specifikimeve teknike dhe kostot ne plan pune konkret, me qëllim për të realizuar shërbimet sipas afatit.

Cilësia pikët **0-10**

Treguesit dhe analizë cilësorë në punë duke përcaktuar elementët e saj.

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e marrëveshjes së kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK si më poshtë vijon:

“Kërkojmë të shfuqizohet vendimi i mëparshëm dhe të ndryshohet vlerësimi me pikë pasi BOE LTE dhe Varaku E disponon të gjitha kapacitetet e nevojshme të shprehura në Grafikon dhe Cilësinë e punimeve, gjithashtu edhe si oferta me e mirë në çmim duke kursyer Bashkisë Shijak 2.627.374 lekë pa TVSH, nga buxheti i saj. Kërkojmë vlerësimin mepikë të plota për BOE LTE dhe Varaku E”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 20.03.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro